



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS**  
APELACIONI SUD KOSOVO – THE APPELLATE COURT OF KOSOVO

---

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për periudhën 6 ( gjashtë ) muaj dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik si dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2014,për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e procedurave për Themelimin e Mardh enjës së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ nr.04/2016 për rregullimin e procedurës së rekrutimit për punësimet me kontrata të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nenshtrohen Ligjit për Detyrime, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015, Gjykata e Apelit të Republikës së Kosovës rishpallë këtë:

**KONKURS**  
**Nr.09.2017**  
**Për angazhim të përkohshëm**

**Titulli i vendit të punës: Vozites**

**Koeficienti: 5**

**Kohëzgjatja e angazhimit: Me afat të caktuar, 6(gjashtë) muaj**

**Raporton tek: Administratori**

**Vendi: Prishtinë-Pejë- (Përparsi kanë kandidatët nga Regjioni i Pejës)**

**Qëllimi i vendit të punës**

Bënë ngasjen e veturave të gjykatave dhe siguron mirëmbajtjen e tyre dhe servisimin e tyre te rregullt.

**Detyrat kryesore:**

1. Bënë vozitjen e përditshme të veturave dhe eliminon defekte te vogla.....10%
2. Raporton për probleme te ndryshme teknike të veturave.....20%
3. Ndërmerr detyrat të vozitjes siç është kërkuar dhe i realizon ato.....10%
4. Dërgon dhe pranon posten nga institucionet e ndryshme për nevoja të gjykatës.....10%
5. Transporton punëtorët që punojnë ne gjykatë pas orarit te punës.....10%
6. Përcjell gjendjen e automjetit dhe lajmëron për kohën e regjistrimit dhe sigurimit të tij.....20%
7. Kontrollon shpenzimet e automjetit që përdorë dhe raporton për automjet ne baze te udhëzimeve përkatëse.....10%
8. Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës kur te angazhohet nga mbikëqyrësi.....10%

**Shkathësitë aftësitë e kërkua:**

1. Shkathësi për ngasje të automjetit dhe njohja e rrugëve të Kosovës.
2. Njohja e problemeve të vogla teknike në automjet dhe aftësia për rregullimin e tyre.
3. I aftë të përpiloj raport për llogaritjen e shpenzimeve dhe kilometrave të kaluar për automjetin që vozitë dhe te raportoj për të.
4. Aftësi të komunikimit me gojë dhe me shkrim

**Kualifikimi arsimorë dhe profesionalë për këtë post:**

1. Shkollë e mesme dhe së paku tre (3) vite përvojë pune nga natyra e njëjte-----e nevojshme.

**Shënim:** Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatet e jashtëm si dhe për nëpunësit civil ekzistues.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me rregullativen ligjore te cekur me lartë.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Pallati i Drejtësisë , objekti B- Lagjja "Prishtina e Re", Rr.:" Nekibe Kelmendi" pn.

Dorëzimi i aplikacioneve mund te bëhet edhe përmes postes.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-18-788, prej orës 08:00 - 16:00.

**Konkursi është i hapur 3 ditë** nga dita e publikimit në web-faqen zyrtare dhe tabelën e shpalljeve te Gjykatës Apelit, duke filluar nga data **17.05.2017**, deri më datën **19.05.2017**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit.

[Shkarko Aplikacionin](#)

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 2 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Përdorimi i aplikacionit/formularit te gabuar do të konsiderohet i pa vlefshem.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.